



KUVENDI KOMUNAL PEJË

Komiteti për Politikë e Financa

L.Numër: 060/01-97914

Pejë, datë: 16 Dhjetor 2024

PROCESVERBAL

Nga takimi i **XI-** i Komitetit për Politikë e Financa i KK-së Pejë, mbajtur me **16 dhjetor 2024**, në orën 11:00.

Takimi u mbajt në sallën e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pos anëtarëve të komitetit, në këtë takim prezantojnë: Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, drejtori i ÇPJ-së z.Ariqanit Krasniqi, Udhëheqës i Sektorit të Kuvendit, z. Avni Gashi, znj. Donjeta Morina, Asistente e kryesuesit, znj.Florlinda Berisha, dhe përfaqësuesit e ZIP-it.

Takimin e hapi dhe e udhëhoqi, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, i cili hapi diskutimin për rendin e ditës, dhe i sqaroi të gjitha pikat të cilat janë vendosur në rend ditë. Po ashtu sqaroi se antarja znj.Xhevahire Çeku Kelmendi, ka dhënë dorëheqje dhe do të zëvendsohet me antarin që është në radhë në listen e pritjes. Gjithashtu sqaroi se janë ardh disa pika shtesë që i kemi marrë prej drejtorisë ÇPJ-së pika 8,9,10,12 .

Z.Berat Ganiqi: në rend dite kisha pas me shtu se të gjitha materialet që janë ktu që kanë të bëjnë me këmbim janë ardh në orën 10:47 dhe për mua është e pa nevojshme me mbajtë një mbledhje ku 13 minuta më heret është ardh dokumentacioni. Me ligj është e specifikume që 7 ditë të javës duhet me ardh materiali, kjo është bërë praktik dhe ne si Lëvizje Vetvendosje nuk e shoh të arsyshme në asnjë pikë me marrë pjesë, materiali vjen me kohë tjera here pëmdryshe kësi mbledhje nuk marr pjesë ku 13 minuta para mbledhjes na vjen materiali!

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: rendi ditës ka ardh 1 javë përpara me konkluzione si informatë që të shqyrtohet në KPF me anëtarët e kuvendit, mirpo për shkak të procedurave të ÇPJ-së dhe të kryetari nuk kanë mujt me ardh materialet me kohë. Por sidoqoftë ka kohë me u shqyrtu

materiali deri në scancën e kuvendit ka 10 ditë kohë. Po ashtu edhe sot që kanë ardh me vonesë e kemi prezent drejtorin që mundet me na sqaru!

Pas diskutimeve nga të gjithë anëtarët prezent u miratua ky rend dite, me 4 vota pro, 2 anëtar nuk marrin pjesë në votim dhe 2 anëtar nuk janë prezent,

Rendi i Ditës

1.Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.

2.Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të KPF-së dt. 18.11.2024.

3.Shqyrtimi dhe rekomandimi për Kuvend për miratim e Planit Vjetor të Punës së KKSBB-së.

4.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të z. Bashkim Tatari, për realizimin e shtegut të ecjes buzë Lumit “Lumbardhë” me qëllim të përmbushjes së interesit publik sipas PZHK-së.

5.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të znj. Ryve (Halit) Muqolli , me qëllim të realizimit të shtegut të ecjes buzë lumit “Lumbardhë”.

6.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të z. Valon (Rexhep) Kaligani, me qëllim të regullimit të shtratit të Lumbardhit – hapjes së shtegut të ecjes buzë lumit “Lumbardhë” sipas PZHK.

7.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronë private e pronarëve Ergin (Skender Krasniqi) me $\frac{1}{4}$, Newco Green Market L.L.C. me $\frac{1}{4}$, Ismet (Istref) Lajqi me $\frac{1}{4}$ dhe Nuriye (Sali) Lajqi me $\frac{1}{4}$, me qëllim të ndërtimit të Qendrës së Skijimit në Bogë, si Interes Publik.

8.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit i Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale, Parcelea Komunale 00167/41, pronë komunale në fshatin Lutogllavë me sipërfaqe 10085m², ZK Lutogllavë e cila është e destinuar për deponi druri e që është e planifikuar të ipet në shfrytëzim për 15 vite;

9.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit i Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale, Parcelea Komunale 00167/42, pronë komunale, fshati Lutogllavë me sipërfaqe 10086m², ZK Lutogllavë, Deponi - material i fortë, poashtu e paraparë të ipet në shfrytëzim për 15 vite;

10.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit i Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak

të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale, Parcelea Komunale 00167/43, pronë komunale, fshati Lutogllavë, me sipërfaqe 10086m², ZK Lutogllavë, Deponi – Gomë, poashtu e paraparë të ipet në shfrytëzim për 15 vite;

11.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit i Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat gjatë të pronës së paluajtshme Komunale, Zyret e ish QPS-së, përkatësisht në objektin e Soliterit, në Pejë, pronë komunale, të parapara të ipen në shfrytëzim për 35 vite.

12.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit i Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat gjatë të pronës së paluajtshme Komunale, Zyret në katin e tretë tek Poliklinika Stomatologjike janë të parapara të ipen në shfrytëzim për shërbime gastronomike, për 35 vite.

13.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komunale në objekt të Komunës - Parcele Komunale 00167/41, pronë komunale në fshatin Lutogllavë me sipërfaqe 10085m², ZK Lutogllavë e cila është e destinuar për deponi druri e që është e planifikuar të ipet në shfrytëzim për 15 vite;

14.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komunale në objekt të Komunës – Parcelen Kadastrale 00167/42, pronë komunale, fshati Lutogllavë me sipërfaqe 10086m², ZK Lutogllavë, Deponi - material i fortë, poashtu e paraparë të ipet në shfrytëzim për 15 vite;

15.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komunale në objekt të Komunës – Parcelen Kadastrale 00167/43, pronë komunale, fshati Lutogllavë, me sipërfaqe 10086m², ZK Lutogllavë, Deponi – Gomë, poashtu e paraparë të ipet në shfrytëzim për 15 vite;

16.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komunale në objekt të Komunës – Zyret e ish QPS-së, përkatësisht në objektin e Soliterit, në Pejë, pronë komunale, janë të parapara të ipen në shfrytëzim për 35 vite.

17.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komunale në objekt të Komunës - Zyret në katin e tretë tek Poliklinika Stomatologjike janë të parapara të ipen në shfrytëzim për shërbime gastronomike, për 35 vite.

18. Shqyrtimi dhe rekomandimi për Kuvend i Raportit të Punës së NJAB mbi nivelin e rekomandimeve për 2024.

19. Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç janë pranuar:

1. Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.

Nuk ka pasur.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të KPF-së dt. 18.11.2024

Unanimishtë nga të gjithë anëtarët prezent, miratohet procesverbali i KPF-së i dt. 18.11.2024.

3. Shqyrtimi dhe rekomandimi për Kuvend për miratim e Planit Vjetor të Punës së KKSB-së.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: e keni marr materialin paraprakisht, a ka dikush rreth kesaj pike për diskutim?

Unanimishtë nga të gjithë anëtarët prezent, i rekomandohet kuvendit për miratim Plani Vjetor i Punës së KKSB-së.

4. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të z. Bashkim Tatari, për realizimin e shtegut të ecjes buzë Lumit "Lumbardhë" me qëllim të përmbushjes së interesit publik sipas PZHK-së.

Z. Arianit Krasniqi: bëhet fjalë për parcelen me nr. 2960/9 me sipërfaqe prej 56 m² ZK Pejë pronë komunale, e cila propozohet për këmbim me ngastren kadastrale me nr. 6274/2 me sipërfaqe 58 m² ZK Pejë, me qëllim, të realizimit të shtegut të ecjes buzë Lumit "Lumbardhë", për afërsishtë është vlera e njejtë.

Z. Labinot Panxha: meqenëse materiali ka ardh 30 minuta para se me fillu ky takim, konsiderojë se çfarido diskutimi që bëhet apo vendimi që meret këtu është i pa analizuar mire dhe pa i shqyrtuar mirë nga ana e jonë. Mendoj që si anëtar të kuvendit e kemi për detyrë ti shqyrtojmë dhe të marim mendim mbi bazen e atë të cilën e analizojmë. Unë, nuk e kam zgjedhë formën e protestes për me u largu sepse unë e kam humb ditën diku tjetër për me ardh këtu, me i thënë këto që po i them tash, sepse ata qytetarë që na kanë besu e na kanë sjellë këtu me punu dhe me i dhënë vrejjet tona e mos me zgjedhë formën e ikjes apo largimit prej përgjegjësisë. Unë, për mos me marr fjalën në të gjitha pikat po kërkoj prej juve që nga pika 4- 17 të mos i qitni në votim! Sepse unë po deklarohej në emer të Aleancës se nuk do ti votojmë dhe nuk do të marrim pjesë në votim, me 4 vota nuk do të kalojnë dhe nuk mund të i rekomandohen kuvendit. Keni

parasysht sepse këto vendime kanë me shku edhe në MAPL dhe mundën me u kthyer mbrapa vetëm për procedurë, andaj po kërkoj që të vazhdoni me piken 18 dhe 19 . Sepse për këto që fola që nuk i kemi analizuar dhe për të cilat ju nuk e keni votën, nuk besoj që duhet me u vendos në votim.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: unë jam mundu edhe herave të tjera me ju shpjegju që KPF-ja nuk kthen mbrap, sidomos për shkak të vonës së materialeve nuk kthen mbrapa, KPF-ja mundet me kthyer nese gjë defekt në procedurë ose defekt ligjorë me kthyer mbrapa për me rregullu gabimin drejtoria përkatëse! Mundet mos mi marr votat në KPF por nuk mundet me u kthyer mbrapa pasi që kryetari dhe kryesusi i kuvendit kanë bazë ligjore që me dergu në kuvend.

Z.Arianit Krasniqi: vetëm një sqarim për shkak të vonës, sepse në të kaluarën ka qenë ajo forma e procedurës që me i sjellë në kuvend pastaj në vlersim, tani duhet njëherë në vlersim pastaj në kuvend dhe po na vonohen edhe procedurat e vlersimit deri sa po i sjellin me postë.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 4 votë pro, 2 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të z. Bashkim Tatari.

5.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të znj. Ryve (Halit) Muqolli , me qëllim të realizimit të shtegut të ecjes buzë lumit “Lumbardhë”.

Z.Arianit Krasniqi: bëhet fjalë propozimin e kryetarit për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me nr.3428/2 me sipërfaqe prej 71m², me pronën private të znj.Ryve Muqolli me nr. 6303/1 me sipërfaqe 61m², 2296/3 me sipërfaqe 11m² ZK Pejë, me qëllim të realizimit të ecjes buzë lumit “Lumbardhë”.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 4 votë pro, 2 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të znj. Ryve (Halit) Muqolli.

6.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të z. Valon (Rexhep) Kalijani, me qëllim të rregullimit të shtratit të Lumbardhit – hapjes së shtegut të ecjes buzë lumit “Lumbardhë” sipas PZHK.

Z.Arianit Krasniqi: fjala është për propozimin e kryetarit për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronarin privat z.Valon Kalijani. Objekt i këmbimit janë ngastrat kadastrale nr.2213/3 me sipërfaqe 127m² dhe nr.3440/20 me sipërfaqe prej 159m² ZK Pejë pronë komunale, me pronën private të z.Valon Kalijani ngastra me nr.2214/2 me sipërfaqe prej 152m² me qëllim të përmbushjes së interesit publik dhe rregullimin e shtratit të Lumbardhit, dhe hapjen e shetitores.

Nga të gjithë anëtarët prezant me 4 votë pro, 2 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të z. Valon (Rexhep) Kalijani.

7.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronë private e pronarëve Ergin (Skender Krasniqi) me ¼, Newco Green Market L.L.C. me ¼, Ismet (Istref) Lajqi me ¼ dhe Nuriye (Sali) Lajqi me 1/4, me qëllim të ndërtimit të Qendrës së Skijimit në Bogë, si Interes Publik.

Z.Arianit Krasniqi: ky propozim këmbimi është bërë edhe në të kaluarën një pjesë ngjitur me këtë, dhe këtë pjesë e patëm dërguar për vlerësim dhe shpronësim por pasi që komuna nuk pat mjete me pagu atëherë jemi obliguar me shku në formatin e këmbimit. Propozohet për këmbim prona komunale me pronë private e pronarëve Ergin (Skender Krasniqi) me ¼, Newco Green Market L.L.C. me ¼, Ismet (Istref) Lajqi me ¼ dhe Nuriye (Sali) Lajqi me 1/4, me qëllim të ndërtimit të Qendrës së Skijimit në Bogë, si Interes Publik.

Nga të gjithë anëtarët prezant me 4 votë pro, 2 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim propozimi Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronë private e pronarëve Ergin (Skender Krasniqi) me ¼, Newco Green Market L.L.C. me ¼, Ismet (Istref) Lajqi me ¼ dhe Nuriye (Sali) Lajqi me ¼.

8.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit i Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale, Parcelea Komunale 00167/41, pronë komunale në fshatin Lutogllavë me sipërfaqe 10085m², ZK Lutogllavë e cila është e destinuar për deponi druri e që është e planifikuar të ipet në shfrytëzim për 15 vite;

Z.Arianit Krasniqi: parcela përballë deponisë kemi pas presione edhe në fillim kur e kemi vendosur në listë që e kemi përfshirë për dhënie në shfrytëzim! Ka qenë kërkesa prej tyre që ndrojnë guma sepse në të kaluarën i kishin kallur pasi që të kalon kjo procedurë kemi me bërë thirrje me dhënie në shfrytëzim kush ka interes aplikon dhe mundet me marr të drejtën e shfrytëzimit . Tri pikat e rendit të ditës kanë të bëjnë me trajtimin e mbeturinave të llojit të caktuar.

Nga të gjithë anëtarët prezant me 4 votë pro, 2 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, kjo pikë i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim në seancën e kuvendit.

9.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit i Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale, Parcelea Komunale 00167/42, pronë komunale, fshati Lutogllavë me sipërfaqe 10086m², ZK Lutogllavë, Deponi - material i fortë, poashtu e paraparë të ipet në shfrytëzim për 15 vite;

Nga të gjithë anëtarët prezent me 4 votë pro, 2 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, kjo pikë i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim në seancën e kuvendit

10.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit i Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale, Parcelea Komunale 00167/43, pronë komunale, fshati Lutogllavë, me sipërfaqe 10086m², ZK Lutogllavë, Deponi – Gomë, poashtu e paraparë të ipet në shfrytëzim për 15 vite;

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: nese nuk ka dikush diqka për diskutim athere e qesim në votim.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 4 votë pro, 2 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, kjo pikë i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim në seancën e kuvendit.

11.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit i Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat gjatë të pronës së paluajtshme Komunale, Zyret e ish QPS-së, përkatësisht në objektin e Soliterit, në Pejë, pronë komunale, të parapara të ipen në shfrytëzim për 35 vite.

Z.Arianit Krasniqi: bëhet fjalë për zyret e ish QPS-së, ato zyrc kanë mbet bosh dhe është e nevojshme me i jep në shfrytëzim pastaj me inicu me proceduren e nevojshme.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 4 votë pro, 2 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, kjo pikë i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim propozimi i Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat gjatë të pronës së paluajtshme Komunale, Zyret e ish QPS-së, përkatësisht në objektin e Soliterit, në Pejë, pronë komunale, të parapara të ipen në shfrytëzim për 35 vite.

12.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit i Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat gjatë të pronës së paluajtshme Komunale, Zyret në katin e tretë tek Poliklinika Stomatologjike janë të parapara të ipen në shfrytëzim për shërbime gastronomike, për 35 vite.

Z.Arianit Krasniqi: bëhet fjalë për një restaurant për shërbime gastronomike është e parapar të ipet në shfrytëzim për 35 vite.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 4 votë pro, 2 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, kjo pikë i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim propozimi i Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat gjatë të pronës së paluajtshme Komunale, Zyret në katin e tretë tek Poliklinika Stomatologjike janë të parapara të ipen në shfrytëzim për shërbime gastronomike, për 35 vite.

13.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të

pronës së paluajtshme Komunale në objekt të Komunës - Parcelles Komunale 00167/41, pronë komunale në fshatin Lutogllavë me sipërfaqe 10085m², ZK Lutogllavë e cila është e destinuar për deponi druri e që është e planifikuar të ipet në shfrytëzim për 15 vite;

Z.Arianit Krasniqi: e kemi propozimin për formimin e komisionit për vlersimin e dokumentacionit. Në kuader të konkluzionit i shihni që janë 2 anëtar nga kuvendi, 2 anëtar nga ekzekutivi drejtoresha e inspeksionit dhe e administrates, po ashtu duhet të jetë edhe një anëtar nga OJQ-të. Për antarin nga OJQ-të duhet të bëjmë një thirrje në kuvend!

Z.Avni Gashi: ne e bëjmë një thirrje publike me datën 23.12.2024 me marr pjesë antaret e shoqërisë civile, qytetarë të thjeshtë, me i zgjedhë 5 anëtar për secilin komision edhe me kqyr edhe barazinë gjinore!

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: të gjitha pronat që janë propozu për dhënje në shfrytëzim afatë shkurtër dhe afatë gjatë duhet të jetë nga një komision i veçantë , i cili duhet të i votoj njëkohësishtë në seancën e kuvendit dhe delegohen deri në zhvillimin e procedurave të realizimit e kontrates së dhënjes në shfrytëzim. Një antar nga ekzekutivi duhet të ndrohet znj.Nita Panduri, pasi që është në komisionin e ankesave nuk mund të marr pjesë edhe në komisionin vlersues, deri në seancën e kuvendit propozohet një emer tjetër nga ekzekutivi për të gjitha këto 5 komisione.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 4 votë pro, 2 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, kjo pikë i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim .**14.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komunale në objekt të Komunës – Parcelen Kadastrale 00167/42, pronë komunale, fshati Lutogllavë me sipërfaqe 10086m², ZK Lutogllavë, Deponi - material i fortë, poashtu e paraparë të ipet në shfrytëzim për 15 vite;**

Nga të gjithë anëtarët prezent me 4 votë pro, 2 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, kjo pikë i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

15.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komunale në objekt të Komunës – Parcelen Kadastrale 00167/43, pronë komunale, fshati Lutogllavë, me sipërfaqe 10086m², ZK Lutogllavë, Deponi – Gomë, poashtu e paraparë të ipet në shfrytëzim për 15 vite;

Nga të gjithë anëtarët prezent me 4 votë pro, 2 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, kjo pikë i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

16.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të

pronës së paluajtshme Komunale në objekt të Komunës – Zyret e ish QPS-së, përkatësisht në objektin e Soliterit, në Pejë, pronë komunale, janë të parapara të ipen në shfrytëzim për 35 vite.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 4 votë pro, 2 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, dhe 2 anëtar nuk janë prezent kjo pikë i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

17.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komunale në objekt të Komunës - Zyret në katin e tretë tek Poliklinika Stomatologjike janë të parapara të ipen në shfrytëzim për shërbime gastronomike, për 35 vite.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 4 votë pro, 2 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, dhe 2 anëtar nuk janë prezent, kjo pikë i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

18.Shqyrtimi dhe rekomandimi për Kuvend i Raportit të Punës së NJAB mbi nivelin e rekomandimeve për 2024.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: materialin e keni marr paraprakisht, po e hapim diskutimin nese ka dikush diqka?

Unanimishtë nga të gjithë anëtarët prezent kjo pikë i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim për Kuvend i Raportit të Punës së NJAB mbi nivelin e rekomandimeve për 2024.

19.Pyetjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, ne atë rënditje siç janë pranuar:

Nuk ka pasur.

Pjesë e këtij procesverbali është edhe audio incizimi i këtij takimi të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Meqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime të tjera nuk pat, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj e shpalli të mbyllur këtë takim të KPF-së në orën 11:35 h.

Procesmbajtësja,
znj. Donjeta Morina





